



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK NR.4

Nr. 173 prot

Tiranë me 19.02.2025

Lënda: Njoftim për levizje paralele

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Ne zbatim te ligjit nr. 15/2019, "Per nxitjen e punësimit"; te ligjit nr. 15/2017, "Per arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" : të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554, datë 31.07.2019, "Për krijimin , mmënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; udhëzimit nr.759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësive të zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të Vazhduar profesional të personelit" , mbështetur në Udhëzimin e përbashkët nr. 3 datë 13.12.2024 " Për marrjen në punë të punonjësve me kohë të pjesshe, në qendrat e formimit profesional publik dhe shkollat e mesme profesionale" , QFPP Nr.4, ju njofton krijimin e vendit të lirë të punës (lëvizje paralele) për pozicionin instructor me kohë të pjesshme :

1. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Parukeri, Estetikë, Manikyr Pedikyr---- 4 Persona
2. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Instalime dhe Mirembajtje e rrjetit elektrik , Riparime Elektroshtëpiake , Riparime për paisjet audio dhe televizive ----3 Persona
3. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Instalim dhe mirembajtje hidraulike , ----2 Persona
4. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Kuzhinë ----- 3 Persona
5. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Mobileri ----- 1 Person

6. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Saldim , Hekurpunim ----- 1 Person
7. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Shërbim Shitje , Sipërmarrje dhe menaxhim i biznesit të vogël ----- 2 Persona
8. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Berber ----- 1 Person
9. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Rrobaqepësi , Modelim stilim veshjesh për femra ----- 1 Person
10. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Sekretari , Arkivë ----- 1 Person
11. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Kujdestari Fëmijësh ----- 1 Person
12. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Aftësi për Punësim , Kujdestari për të Moshuar -----1 Person
13. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Kujdestari për Persona me Aftësi të Kufizuara, Kujdestari Sociale ----- 1 Person
14. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Punime Ndërtimi / Bojatisje / Punime muratimi suvatimi / Punime Pllakashtrimi / Administrator Ndërtesash / Hekurkthim / Sisteme të thata në ndërtesa ----- 1 Person
15. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Servis xhenerik në automjete të lehta , Servis Elektroauto në automjete të lehta , Automekanik , Lllamarinist dhe bojatisje autojetesh ----- 2 Person
16. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Termohidraulik, Instalim dhe mirëmbajtje e sistemeve ngrohëse ftohëse , Instalim dhe mirëmbajtje e paneleve diellore ----- 1 Person
17. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Grafik dizajn, Ëëb dizajn , Aftësi digjitale , Riparim Kompjuteri ----- 3 Persona
18. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Gjuhë e huaj Gjermanisht----- 1 Person
19. Instruktor/e të praktikës profesionale për kursin Udhërrëfim Turistik ----- 1 Person

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme janë:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshe për si vijon :

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- b) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën .
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryetjen e veprave penale.
- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.

- e) Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit.
- f) Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit .

Aplikanti duhet të plotësoj kriteret e posaçme si vijon:

- a) Të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose pasuniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon.
- b) Të ketë të paktën 3 (tre)vjet përvojë pune në fushën, në të cilë ka kryer studimet ;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2.Dokumentet e aplikimit:

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në);
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi , të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënes të mëparshëm;
- k) të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentat e aplikimit të dorëzohen në protokollin e ofruesit public të AFP-së, brenda datës 26.02.2025

Duke ju falenderuar per mirekuptimin

DREJTOR
Valbona Hoxha
